

V E N D I M
Nr.763, datë 11.11.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRESËN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.7, DATË 17.8.1993 “PËR TRANSPORTIN RRUGOR PUBLIK TË UDHËTARËVE DHE BAGAZHEVE” DHE NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.621, DATË 20.12.1993 “PËR KOMPETENCAT NË DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË FUSHËN E TRANSPORTEVE DHE KOMUNIKACIONIT”

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.7, datë 17.8.1993 “Për transportin rrugor publik të udhëtarëve e bagazheve”, bëhen këto ndryshime:

- Në fund të nenit 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“të transportojë me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta”.

- Në fund të nenit 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

- udhëtarët që përfitojnë lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji përkatës për ta”.

- Në nenin 15, pas fjalëve “... qendrat ekstreme jetësore”, të shtohen fjalët “dhe industriale”.

- Neni 18 ndryshohet si vijon:

“Transporti publik qytetës i udhëtarëve kryhet nga shoqëri të specializuara për këtë transport. Kryetari i bashkisë vendos për shoqërinë dhe linjën ose linjat në shfrytëzim të saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga këshilli bashkiak”.

- Neni 20 ndryshohet si vijon:

“Kur brenda një rrethi janë më shumë se një bashki, lejet për linjat e rregullta me autobuse mes tyre miratohen nga kryetari i këshillit të rrethit.

Lejet për transport rrugor publik të udhëtarëve me autobuse në linjat që lidhin bashkitë me komunat, lëshohen nga organi i ngarkuar për transportin në bashkinë e qytetit, me miratimin e kryetarit të këshillit të rrethit. Lejet për transport rrugor publik të udhëtarëve me autobuse në linja brenda rretheve, që lidhin komunat ndërmjet tyre, të cilat nuk kalojnë përmes qyteteve, lëshohen nga organi i ngarkuar për transportin në këshillin e rrethit, me miratimin e kryetarit të këshillit të rrethit.

Lejet për transport ndërqytetës, jashtë rrethit, lëshohen nga ministria që përcakton paraprakisht rrjetin e linjave të autobusëve, të cilat do të lidhin rrethet mes tyre”.

- Pika 3 e nenit 22 ndryshohet si vijon:

“Të ketë lidhur një kontratë për sigurimin e mjeteve motorike të veta, për të mos dëmtuar vazhdimin e veprimtarisë për arsye të ngjarjeve të ndryshme ose të ketë derdhur një shumë, si garanci bankare, të barasvlefshme me primin e sigurimit për numrin e mjeteve në inventar”.

- Në nenet 28, 29 dhe 32 fjalët “Personi juridik a fizik” zëvendësohen me fjalët “Shoqëria tregtare”.

- Në nenin 44 fjalët “në transportin e brendshëm” të zëvendësohen me fjalët “në transportin e udhëtarëve” dhe fjalët “jo më pak se një vit” të zëvendësohen me fjalët “për një periudhë trevjeçare”.

- Në nenin 49 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Mjeti autotaksi duhet të qëndrojë në vende të përcaktuara, si dhe të jetë i pajisur me taksimeter, i cili është kolauduar e plumbosur nga organet kompetente. Detyrimi për vendosjen e taksimetrit fillon nga tremujori i dytë i vitit 1997”.

- Në nenin 51 shtohet përcaktimi:

“numrin e nevojshëm të taksive sipas normativave të miratuara nga Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë”.

- Në kreun V “Dispozita kalimtare dhe të fundit” shtohet neni 55/1 me këtë përmbajtje:

“Për krijimin e kushteve për zbatimin e kërkesave të kësaj urdhërese në organizimin dhe disiplinimin e transportit rrugor të udhëtarëve jashtë qytetit, këshillat bashkiake dhe këshillat e

rretheve të përcaktojnë menjëherë në planet rregulluese të qyteteve dhe të marrin masa për ndërtimin e terminaleve të autobusëve, lidhjen e tyre me pjesët e tjera të qytetit dhe me linjat e tjera rrugore, hekurudhore, rregullimin e trafikut rreth tyre etj.”.

2. Në titullin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993, të hiqen fjalët “... dhe komunikacionit”.

- Lista e bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.278, datë 21.6.1994, zëvendësohet me listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.126, datë 25.3.1994, dhe nr.278, datë 21.6.1994, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VEPRIMTARITË NË FUSHAT E TRANSPORTIT, PËR TË CILAT KËRKOHET LEJE E
LËSHUAR NGA:

A. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë

I. Në transportin rrugor

1. Për transportin e udhëtarëve në linjat ndërqytetëse dhe ndërkombëtare.
2. Për transportin ndërkombëtar të mallrave.
3. Për veprimtaritë e shërbimit të agjencive të udhëtarëve, të mallrave dhe spedicioneve.
4. Për përgatitjen dhe kualifikimin e drejtuesve të automjeteve.
5. Për veprimtarinë e kontrollit teknik periodik. Për veprimtarinë e kontrollit teknik periodik së bashku me servis-riparimin. Miratimi paraprak për veprimtarinë e servis-riparimit të subjekteve të huaja ose në bashkëpunim.

II. Në transportin detar, ujqor dhe portet.

1. Për veprimtaritë për transportin detar të mallrave dhe/ose të udhëtarëve midis porteve dhe pontileve detare brenda vendit dhe atyre në transportin ujqor (liqenet etj.)
2. Për transportin detar e ujqor ndërkombëtar për mallrat dhe/ose për udhëtarët.
3. Për shërbimet e agjencive detare, të pilotimit, spedicionit dhe ngarkim-shkarkimit në porte.

III. Në ushtrimin e veprimtarive të lira në fushat e transporteve

- Për ushtrimin e veprimtarive të konsulencës teknike në fushat e transporteve.

B. Nga këshillat e rretheve dhe bashkitë e qyteteve:

I. Në fushën e transportit rrugor

1. Për transportin qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve me autobuse dhe transportin taksi, sipas përcaktimeve të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr.7, datë 17.8.1993.

2. Për veprimtarinë e transportit të mallrave brenda vendit.

3. Për veprimtaritë e servis-riparimit të mjeteve të transportit rrugor, shërbimin dhe rimorkimin e mjeteve të defektuara në rrugë, larjen e automjeteve, parking, gomisteri etj.

II. Në transportin detar e ujqor

1. Për veprimtaritë në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve në liqene brenda rrethit.
2. Për veprimtaritë në lidhje me spostimin e mallrave nga anijet dhe kryerjen e matjeve të mjeteve të transportit detar e ujqor.

III. Në transportin hekurudhor.

- Në veprimtaritë e shërbimeve të ndryshme për mallrat në stacione.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi